

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në trupin e përbërë nga gjyqtarët: Agnieszka Klonowiecka – Milart, kryetare, (gjyqtare ndërkombëtare) dhe Kathleen Weir (gjyqtar ndërkombëtar), sëbashku me gjyqtarin Riza Loci, si antarë të trupit, me procesmbajtësen Tamara Bërnetaq, në lëndën penale P.nr. 17/02 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan të dt. 28 nëntor 2003, kundër të pandehurit **Momçilo Trajković**, në të cilën është shpallur fajtor për veprat penale vrasja në tentativë, të definuar dhe sanksionuar me nenin 30.paragr.1 LPK, lidhur me nenin 19 të LPJ, posedimi i paautorizuar i armëve nga neni 199.paragr.3 të LPK dhe është liruar nga akuza për veprën penale krimi i luftës, të përshkruar në pikat 1-11 të aktakuzës së ndryshuar të prokurorit publik ndërkombëtar të dt. 26 shkurt 2003, të defunuar dhe sanksionuar sipas nenit 142 të LPJ.

Sipas nenit 384 LPP në seancën e mbajtur më dt. **7 shkurt 2006** mori

## A K T G J Y K I M

Ankesa e të pandehurit **refuzohet** kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr. 17/2002 të dt. 28 nëntor 2003 **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

### **Pyetjet të cilat i shqyrtoi Gjykata Supreme.**

Lënda penale P.nr. 17/2002 e Gjykatës së Qarkut në Gjilan ka qenë në rigjykim pas asaj që Gjykata Supreme më dt. 30 nëntor 2001 ka prishë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr. 68/200 të dt. 6 mars 2001. Kështu kjo ankesë ka të bëjë me rigjykimin dhe me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.nr. 17/2002 të dt. 28 nëntor 2003.

Me aktgjykimin e dt. 28 nëntor 2003 i pandehuri Momçilo Trajković është shpallur fajtor për tentim vrasje sipas nenit 30.paragr.1 të LPK lidhur me nenin 19 LP RSFJ edhe për posedim të paautorizuar të armëve siç është defunuar dhe sanksionuar sipas nenit 199.paragr.3 lidhur me paragr. 1 të LPK.

Me të njejtin aktgjykim i pandehuri është liruar nga akuza për krim të luftës të përshkruar në pikat 1-11 të aktakuzës së ndryshuar të prokurorit publik ndërkombëtar të dt. 26 shkurt 2003 definuar dhe sanksionuar me nenin 142. LP RSFJ të cilit i përgjigjet neni 350 (3) LPP.

I pandehuri është gjykuar me tri vite burgim për veprën penale vrasja në tentativë dhe me 4 muaj burg për veprën penale posedimi i paautorizuar i armëve. Gjykata i shqiptoi dënimin unik prej 3 vitesh dhe 3 muaj burg sipas neni 48. par.1 dhe 2 (3) të LP

RSFJ. Në dënim i është llogaritur koha të cilën i pandehuri e kaloi në paraburgim prej dt. 7 shtator 1999 deri më dt. 26 korrik 2002.

Lidhur me veprën vrasja në tentativë, Gjykata e Qarkut mori aktgjykim lirues në bazë të ngjarjes për të cilën ka konstatuar se ka ndodhur me rastin e konfliktit të armatosur në komunën e Kamenicës më dt. 27 qershor 1999 ose rreth asaj date.

Theksohet me më dt. 27 qershor 1999 M [REDACTED] F [REDACTED] dhe A [REDACTED] P [REDACTED] kanë ngritur flamurin shqiptar në stacionin policor në Kamenicë. Theksojnë se pasi kanë bërë këtë, i pandehuri ka shtënë në drejtim të tyre nga ballkoni i banesës së tij në katin e tretë të ndërtesës, përballë stacionit policor. M [REDACTED] F [REDACTED] ka qenë i qëlluar me një fishek në këmbën e djathtë.

Sa i përket veprës posedimit të paautorizuar të armëve është konstatuar se i pandehuri i ka siguruar me datë të panjohur dhe i ka mbajtur deri më dt. 7 shtator 1999. Më dt. 7 shtator 1999 KFOR-i ka bastisur banesën e tij në Kamenicë pasi që është informuar se është plagosur M [REDACTED] F [REDACTED]. I pandehuri më parë ka mohuar se te ky ka ndonjë armë, por gjatë bastisjes ka nxjerrë nga shtrati i tij korpën në të cilën ishte "Kallashi", 2 bomba dhe 300 fishekë. Dëshmitari i të pandehurit T [REDACTED] D [REDACTED] vërtetoi se armët janë sjellur nga banesa e D [REDACTED] vetëm 30 minuta më heret "në ruajtje", pas arritjes së të pandehurit i cili i pengoi hajnat që tentonin të vjedhin në banesën e D [REDACTED]. Trupi vlerësoi se sqarimi i tillë i ngjarjes nuk është bindës.

#### **Ankesa e avokatit mbrojtës Zhivojin Jokanoviq**

Avokati i mbrojtjes Zhivojin Jokanoviq është ankuar kundër aktgjyimit në dënimin bazë:

1. shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale
2. shkeljeve të Ligjit Penal
3. vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike
4. vendimit mbi sanksionin penal.

Avokati i mbrojtjes thekson se ka ardhur deri te shkelja e procedurës nga neni 364.par.1 pika 11 të LPP dhe se dispozitivi është i paqartë, i njejti nuk është i bazuar. Në arsyetim nuk është cekur përse gjykata i pranoi apo i refuzoi deklaratat e dëshmitarëve. Avokati i mbrojtjes posaçërisht e kontestoi vlerësimin e deklaratës së Xh [REDACTED] K [REDACTED].

Avokati i mbrojtjes thekson se duke gjykuar të pandehurin për posedim të paautorizuar të armëve, gjykata ka bërë shkelje të Ligjit Penal, e këtë e ka bërë në "kohën kritike" kur nuk ka pasur vepër penale. Avokati i mbrojtjes pohon se i pandehuri ka siguruar armë në mënyrë të ligjshme. Jo vetëm se për të kishte leje por se dikush është dashur t'i mbaj, se me to e ka ngarkuar shteti i Serbisë për t'u mbrojtur. Pas ardhjes së KFOR-it në Kosovë, situata e mbajtjes së armëve nuk ka ndryshuar, deri sa ka hyrë në fuqi dispozita mbi amnistinë më 22 shtator 1999.

1. Lidhur me veprën penale vrasja në tentativë, Gjykata e Qarkut ka lënë pas dore faktin se në raportet mjekësore nuk ka emër të palës së dëmtuar dhe pranoi "formularin blanko".

2. Dëshmitari okular A ■ P ■, dëshmoi para gjyqtarit hetues se pasi që në stacionin policor është ngritur flamuri shqiptar ka vërejtur si i pandehuri në ballkonin e tij shprehë paknaqësi dhe u fliste diçka serbëve të cilit jetonin përballë banesës së tij. Avokati mbrojtës pohon se ky dëshmitar nuk ka ditur serbisht dhe i njeji nuk ka mundur saktësisht t'i interpretojë fjalët që janë folur. Dëshmitari përsëriti deklaratën e tij me rastin e vëzhgimit të cilin gjykata e bëri më 07. mars 2003. Në atë rast dëshmitari e zvogloi vlerësimin e tij të numrit të fishekëve të cilët kanë ardhur nga dritarja afër ballkonit, prej 7 – 8 në 2 sish.

3. M ■ F ■ dhe A ■ P ■ pohuan se rstin e lajmëruan në KFOR 10 minuta pas ngjarjes. Mbrojtja thekson sikur kjo thënje të ishte e vërtetë, KFOR-i menjëherë do të interesohej. Si duket KFOR-i në të vërtetë është lajmëruar në fillim të shtatorit, e pas kësaj janë konfiskuar armët. I pandehuri pohon se armët kanë qenë të konzervuara dhe se nga ato nuk është shtënë; nuk e din se ku gjinden armët, andaj, ky pohim nuk mund të verifikohet për qëllim të mbrojtjes.

4. Gjykata e Qarkut konstatoi se është gjuajtur nga ballkoni, e kjo përgënjeshtrohet dëshminë e Xh ■ K ■, në të cilën theksohet se i pandehuri nga ballkoni ka folur gjerë, duke theksuar: “nuk mund ta paramendoj...në mes të ditës ...flamuri shqiptar”. Të shtënat janë dëgjuar 10 minuta pas ngritjes së flamurit. Dëshmitari e ka identifikuar zërin e të pandehurit, nuk e din se kush ka shtënë, dëshmitari insiston se të shtënat janë shkrepur nga ballkoni por se të nesërmen gëzhojat janë gjetur në pjesën tjetër të banesës, kah rruga.

5. Më tutje avokati mbrojtës i cekë dallimet në mes dëshmisë së të dëmtuarit M ■ F ■, i cili në procedurën paraprake ka thënë se ka qenë në shërim 5 ditë kurse këtu thekson se është shëruar 10 ditë. Ky dëshmitarë përsëritë se është shtënë nga ballkoni dhe se i pandehuri më atë rast ka folur shumë. Dëshmitarët tjerë këtë nuk e pohojnë.

6. Avokati mbrojtës më tutje pohon se vlerësimet e trupit në gjykimin e parë dhe në rigjykim janë kontradiktore. Thekson se njëri trup ka konstatuar se është e pa mundur që të jetë shtënë nga dritarja afër ballkonit, por nga një dritare krejt tjetër, çka është e kuptueshme, duke qenë se gëzhojat janë gjetur në atë anë. Mbrojtësi spekulon se gëzhojat kanë mbetur në dhomë pavarësisht se nga cila dritare është shtënë. Në rasin konkret të tre dëshmitarët theksuan se është shtënë nga ballkoni apo dritarja afër ballkonit.

7. Më tutje avokati mbrojtës pohon se Gjykata e Qarkut nuk e ka vlerësuar mjaft alibinë e të pandehurit. Kushdo që t'i ketë analizuar ngjarjet do të kishte ardhur deri te përfundimi i shëndoshë i mendjes se është sigurisht pak që i pandehuri të kishte shtënë në kë do në kohën kur formacionet e UÇK-ës kanë qenë në çdo kënd të Gjilanit.

#### Mendimi i ZPPK

ZPPK konsideron se Gjykata Supreme duhet të merr aktgjykim me të cilin do ta hudhë ankesën e të pandehurit si juridikisht të pa bazuar, në bazë të nenit 384 të LPP.

Sa i përket pohimit të avokatit mbrojtës aktgjykimi përmbanë shkelje esenciale të dispozitës së procedurës penale, ZPPK konsideron se dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, nuk është kontradiktor dhe i njëanshëm.

ZPPK është i mendimit se aktgjykimi gjykues është i bazuar në provat e paraqitura – deklaratës së A P dhe dëshmitarit të pavarur Xh K.

Lidhur me faktin se gjykata ka pranuar raportin mjekësor si provë mbi lëndimet të cilat i janë shkaktuar palës së dëmtuar, ZPPK konsideron se gjykata ka disponuar mjt prova, siç është cekur në arsyetim të aktgjykimit, për të vërtetuar se raporti vërtetë ka të bëjë me palën e dëmtuar.

ZPPK përgënjeshton pohimin e avokatit mbrojtës se duhet hudhur akuzën për armë. ZPPK konsideron se gjykata drejtë ka konstatuar se i pandehuri ka poseduar dhe ka fshehur armë për të cilat nuk ka pasur leje, me këtë duke u bërë i shurdhër mbi për dispozitën mbi amnistinë, për të ciën e ka ditur. Aq më shumë, gjykata në mënyrë të drejtë ka hudhur dëshminë e T D, si të pa argumentuar.

Lidhur me sanksionimin e të pandehurit, ZPPK vëren se avokati mbrojtës nuk ka paraqitur thëniet e tij mbi shkeljet e nenit 363 (4) LPP. ZPPK qëndron, se dënimi i caktuar i të akuzuarit është aq i butë sa që nuk e plotëson qëllimin e ndëshkimit. ZPPK pohon se Gjykata e Qarkut ka bërë shkelje të Ligjit Penal sepse ka zvogluar dënimin për secilën vepër penale dhe se nuk ka cekur bazën ligjore për ato zvoglime. ZPPK pohon, bile edhe nëse supozojmë se Gjykata e Qarkut ka vepruar në bazë të nenit 42 LP RSFJ, gjendja e konstatuar faktike nuk përmbanë rrethanat lehtësuese në të cilat gjykata mund të thirrej. Megjithatë, duke qenë se prokurori publik i qakut nuk është ankuar, Gjykata Supreme nuk mund t'i rritë dënimet sepse me këtë do të shkelte ndalimin *reformationis in peius*.

Gjykata Supreme konstatoi si vijon:

***Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale***

Gjykata Supreme gjenë se nuk ka ardhur deri te shkelja e procedurës penale sipas nenit 364 par. 1 pika 11. Vërejtjet e avokatit mbrojtës se në aktgjykim nuk është arsyetuar përse janë pranuar disa deklaratat si ajo e Xh K, e disa janë hudhur, këtu sigurisht mendohet në deklaratën e të pandehurit dhe deklaratën e T D, nuk kanë bazë.

Gjykata Supreme gjenë se Gjykata e Qarkut ka dhënë mjaft arsye në f. 26 në verzionin anglez të aktgjykimit, për pranimin e deklaratave të Mevlud Fazliut dhe Arif Pirevës të cilat i vërtetoi Xh K, dhe për hudhjen e deklaratave të dëshmitarëve të mbrojtjes:

*“Trupi gjykues në përgjithësi është vërtetuar se kjo vepër penale është argumentuar. Përveç deklaratës së palës së dëmtuar dhe shokut të tij, gjykata ka mundur të mbështetet në deklaratën e Xh K, dëshmitarit neutral, i cili ka dëshmuar se në kohën kritike i pandehuri ka qenë në banesën e tij, i cili dëgjoji kur i pandehuri shprehi paknaqësinë e tij, me veprimet e të dëmtuarit dhe të shokut të tij, dëgjoji të shtënat, vërtetoi se në atë kat të ndërtesës së banimit nuk ka jetuar askush përveç të pandehurit, i cili ka gjetur gëzhajat nën banesë”*

Gjykata Supreme gjeti se aktgjykimi nuk është i pa kuptueshëm; intrinzisht jo konsekuent ose jo konsekuent me arsyetimin e aktgjykimit; se është i bazuar dhe i qartë dhe se nuk është kontradiktor në ndonjë mënyrë tjetër.

### ***Shkelja e Ligjit penal***

Avokati mbrojtës pohoi se i pandehuri në mënyrë ligjshme ka siguruar dhe mbajtur armë dhe se me hyrjen në fuqi të amnistisë më 22 shtator 1999, dmth. pas veprës së kryer, është ndryshuar korniza ligjore. Mbrojtja pohon se armët janë siguruar në mënyrë të ligjshme sepse të njejtat i ka dhënë shteti me qëllimin, për t'u mbrojtur. Gjykata Supreme vëren se mbrojtja këtë pohim nuk e ka paraqitur me asnjë provë. Në deklaratën e tij i pandehuri asnjëherë nuk ka përmendur se armët i ka pranuar nga shteti. Aq më shumë, Gjykata Supreme gjenë se këtë pohim e përgënjeshtrojnë deklaratat e vet të pandehurit se armët i ka zbuluar vetëm 30 minuta para se KFOR-i të bëjë bastisjen e banesës. Radhitja e tillë e ngjarjes është direkt kundërthënëse me pohimin se të pandehurit se armët ia ka dhënë shteti. Në ndriçim të kësaj, Gjykata Supreme habitet se si avokati mbrojtës ka paraqitur një pohim të tillë i cili nuk është i bazuar në deklaratën e klientit të tij e as në udhëzimet e tij.

Gjatë muajit shtator të vitit 1999 mbajtja e armëve dhe mjeteve shpërthyesë pa leje ka paraqitur vepër penale sipas nenit 199 të LPK. Në ndriçim të kësaj Gjykata Supreme vërteton gjetjet e Gjykatës së Qarkut se i pandehuri armët i ka mbajtur në mënyrë të kundërligjshme, kjo do të thotë nuk ka pasur leje për mbajtjen e këtyre armëve.

Lidhur me mendimin e avokatit mbrojtës se si rezultat i amnistisë e cila ka hyrë në fuqi më 22 shtator 1999, "askend nuk ka mundur ta ndjek për mbajtje të armëve", është e qartë se avokati mbrojtës gabimisht ka interpretuar pasojat juridike të amnistisë. Në të vërtetë, efekti i amnistisë ka qenë pikërisht i kundërt. Me amnisti u është ofruar rasti njerëzve të cilët armët i kanë mbajtur pa leje, që për një afat të shkurtër t'i dorëzojnë dhe në atë mënyrë t'i shmangen ndjekjes. Andaj, pohimi i avokatit mbrojtës se mbajtja e armëve nuk ka paraqitur vepër penale para 22 shtatorit 1999, është e paqëndrueshme sepse edhe Gjykata Supreme gjen se se Gjykata e Qarkut nuk ka bërë shkelje të ligjit penal duke e gjykuar për armëmbajtje pa leje.

### ***Faktet e konstatuara gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë.***

Gjykata Supreme gjenë se Gjykata e Qarkut me të drejtë ka pranuar dhe është mbështetur në konstatimin mjekësor, kjo do të thotë se në evidencën e spitalit të Gjilanit, M■■■■ F■■■■ i është shkaktuar plagosja nga arma e zjarrtë. Gjykata Supreme analizoi konstatimin mjekësor dhe e përkrahë ZPPK se edhe pse raporti mjekësor nuk është në emër të M■■■■ F■■■■ (por M■■■■ V■■■■), nga i njejtë krejt është e qartë se bëhet fjalë për palën e dëmtuar dhe për lëndimet nga arma e zjarrtë. Në raportin mjekësor ceket emri i M■■■■ V■■■■ i lindur në vitin 1970 nga Kamenica, i cili është plagosur nga arma e zjarrtë në gjurin e djathtë. Konstatimi është i dt. 27 qershor 1999 dhe i njejtë konstatim është konsekuent me deklaratën e palës së dëmtuar dhe A■■■■ P■■■■. Sa i përket pohimit të mbrojtjes se Gjykata e Qarkut nuk e ka arsyetuar pranimin e kësaj prove, Gjykata Supreme pajtohet me vërejtjen e ZPPK se kjo nuk ka qenë e detyrueshme. Raporti mjekësor (fotokopja) është pranuar si provë sipas dispozitave të LPP. Gjykata Supreme vëren se vërejtja kryesore e avokatit mbrojtës në shqyrtim ishte ajo që raporti nuk është

autentik por se bëhet fjalë për fotokopje e jo për originalin. Megjithatë, faktin se M [REDACTED] F [REDACTED] është plagosur nga arma e zjarrtë e kanë vërtetuar dëshmitarët.

Lidhur me vërejtjen e avokatit mbrojtës në atë se si gjykata ka vlerësuar deklaratën e A [REDACTED] P [REDACTED], Gjykata Supreme konsideron se me të Gjykata e Qarkut nuk ka bërë kurëfar gabimi faktik. Mbrojtja e kontestoi atë se gjykata ka pranuar deklaratën e A [REDACTED] P [REDACTED] me fjalët të cilat i pandehuri i ka thënë në gjuhën serbe. Gjykata Supreme konsideron se duke pasur parasysh deklaratat e palës së dëmtuar dhe Xh [REDACTED] K [REDACTED] të cilat shkojnë në shtojcë të kësaj, Gjykata e Qarkut me të drejtë ka konstatuar se i pandehuri para se të shkrep në palën e dëmtuar dhe mikun e tij ka shprehur paknaqësinë, me veprimet e tyre.

Gjykata Supreme nuk e pranon vërejtjen e avokatit mbrojtës në deklaratën e A [REDACTED] P [REDACTED] lidhur me numrin e fishekëve, të cilët i pandehuri i ka shkrepur, për t'u sjellë në pyetje dëshmia e tij në tërësi. Gjykata Supreme këtë e konsideron si materialisht konsekuente e cila nuk sjellë në pyetje konstatimet e Gjykatës së Qarkut. Ajo që është e rëndësishme është se janë shkrepur disa predha dhe se me të njejtë pala e dëmtuar është plagosur. Më tutje, pyetja rreth datës se kur është lajmëruar incidenti nuk ndikon në vërtetimin e gjendjes faktike të cilën e ka konstatuar gjykata.

Mbrojtja është ankuar në atë se në shqyrtim nuk është sjellur arma të cilën kinse i pandehuri e ka përdorur, gjykata i ka shkelur të drejtat e mbrojtjes. Mbrojtja pohon se kjo do t'i kishte ofruar mundësinë të argumentoj se nuk është shtënë nga ajo armë. Gjykata Supreme nuk pajtohet; deri te shkelja e tillë nuk është ardhur. Së pari, gjatë shqyrtimit gjykata nuk ka disponuar me këtë armë. Së dyti, në mes të incidentit dhe arrestimit kanë kaluar afër dy muaj. Gjykata e Qarkut nuk ka vërtetuar se armën të cilën e ka konfiskuar KFOR-i ka qenë e njehta armë me të cilën është kryer sulmi në palën e dëmtuar. Është e mundur që arma e konfiksuar në muajin shtator të vitit 1999, të mos ketë kurrfar lidhje me atë që është përdorur më 27 qershor të vitit 1999.

Gjykata Supreme më tej gjen se Gjykata e Qarkut nuk i ka tejkalar të drejtën e tij diskrete të vlerësimi i deklaratës së Xh [REDACTED] K [REDACTED]. Lokacioni i gëzhgojave, gjykuar nuk është aq i rëndësishëm për t'u konstatuar fajësia e të pandehurit. Dëshmitari ka gjetur gëzhgojat të nesërmën pas të shtënave. Nuk ka prova se gëzhgojat janë gjetur në vendin e njejtë në të cilin kanë ra, pasi që kanë shkrepur nga arma. Është e mundur, psh., që gëzhgojat të jenë mbledhur nga ballkoni i banesës dhe të jenë gjuajtur në tokë. Është e mundur që të jenë lëvizur gjatë periudhës së shkaktuar. Më tutje, asnjëherë nuk është vërtetuar se gëzhgojat të cilat i përmend dëshmitari janë ato të cilat janë shkrepur nga arma të cilën e ka përdorë i pandehuri.

Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Qarkut nuk ka ardhur deri te konkludimi i gabuar në bazë të deklaratës së M [REDACTED] F [REDACTED] lidhur me kohëzgjatjen e shërimit të tij. A është shëruar ai 5 apo 10 ditë nuk ka pasoja në gjykimin e të pandehurit për tentim vrasje. Gjykata e Qarkut pranoi deklaratën e M [REDACTED] F [REDACTED] se ka qenë i qëlluar dhe se i janë shkaktuar lëndime nga të cilat është dashur të mjekohet. Kjo është e paraqitur me raportin mjekësor. Sa i përket deklaratës së M [REDACTED] F [REDACTED] lidhur me fjalët të cilat i ka shqiptuar i pandehuri, shiko konstatimin e Gjykatës Supreme më lart.

Edhe pse ekzistojnë disa diskrepcione lidhur me këtë se a është shtënë nga ballkoni apo nga banesa e të pandehurit, gjykata qartë dhe drejt ka konstatuar se në bazë

të deklaratës së dëshmitarit se i pandehuri ka shtënë në palën e dëmtuar nga vendi në afërsi të banesës së tij, dmth. qoftë nga ballkoni apo nga dritarja afër tij. Është konstatuar dhe nuk është kontestuar se në kohën e të shtënave i pandehuri ka qenë vetë në banesën e tij.

Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Qarkut drejt ka vepruar kur ka hudhur alibinë e të pandehurit. Lidhur me këtë arsyetimi në aktgjykim është i qartë dhe shkurtër.

*“kjo deklaratë e (Xh [REDACTED] K [REDACTED]) qartë paraqet deklaratën e palës së dëmtuar dhe mikut të tij dhe në tërësi e konteston deklaratën e të pandehurit dhe dëshmitarit të mbrojtjes”*

Tre dëshmitarët e akuzës e kanë identifikuar të pandehurin kurse dëshmitarët e mbrojtjes, S [REDACTED] N [REDACTED] dhe Z [REDACTED] J [REDACTED], nuk kanë paraqitur bindshëm alibinë. Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Qarkut nuk ka tejkalluar të drejtën e tij diskreative duke vlerësuar peshën e provave dhe me të drejtë ka hudhur alibinë për shkak të bindshmërisë së thënjeve në akuzë.

### ***Vendimi mbi sanksionin penal***

Gjykata e Supreme vëren se avokati mbrojtës nuk ka arsyetuar detalisht ankesën e tij kundër vendimit mbi sanksionin penal. Gjykata Supreme merr parasysh vërejtjet e ZPPK se ka ardhur deri te shkelja e LPP sepse gjykata ka zvogluar dënimet për secilën nga veprat, pa bazë ligjore, ashtu që ato janë tejet të buta.

Gjykata Supreme gjen se Gjykata e Qarkut me të drejtë ka marr parasysh “të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në peshën e dënimit”, ashtu si parasheh neni 41 (1) të LP RSFJ. Te vlerësimi i paraparë me ligj gjykata nuk gjeti rrethana lehtësuese. Por, duke qenë se është i obligueshëm *principom reformationis in penius*, gjykata nuk ka shqiptuar dënim më të madh nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, edhe pse ka gjetur se dënimet e shqiptuara në gjykatën e shkallës së parë janë të buta. Për këtë arsye për veprat penale vrasja në tentativë dhe mbajtja e paautorizuar e armëve, gjykata i ka shqiptuar njëjtë si gjykata e shkallës së parë. Përveç kësaj, në rigjykim gjykata i ka zvogluar dënimin duke aplikuar dënimin unik sipas nenit 48. paragr.1 LP RSFJ. Gjykata Supreme gjen se te caktimi i dënimit për të pandehurin nuk ka ardhur deri te shkelja e Ligjit penal.

Nga të gjitha këto arsye, në bazë të nenit 384. LPP, është vendosur si në dispozitivin e cekur.

Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë  
Ap.nr. 7 shkurt 2006.

Procesmbajtësja,  
Tamara Bërnetiq

Kryetari i trupit – gjyqtari,  
Agnieszka Klonowiecka – Milart

Përktheu,  
Naila Keçmezi

